

INNOVET ALBANIA BULETIN

Na ndiqni në:
Website: www.albanianskills.org
Media Sociale: AlbanianSkills
Email: albanianskills@gmail.com

Dhjetor, 2020 | Numri 01

Përshëndetje nga
Albanian Skills!
Ju urojmë një Sezon
të Gëzuar Festash!

Të dashur lexues,

Është kënaqësi e madhe t'ju prezantojmë me këtë edicion të parë të Revistës tonë INNOVET Albania në Vigili të 2021 dhe në Sezon Pushimesh. Është rikonfirmuar se aftësitë mbeten jetike për njëzësim, pavarësisht vitit të vështirë që po lëmë pas, i cili ka sjellë gjithashtu mundësi të reja për të gjithë ne. Digjitalizimi i thellë dhe i vazhdueshëm i ekonomive dhe shoqërive tona kërkon në vijimësi mënyra inovatore dhe të guximshme të të menduarit, të mësuarit dhe të jetuarit. Si digjitalizimi, edhe novacioni po ndikojnë në ekonominë botërore, dhe jo vetëm duke kontribuar në produktivitet dhe efikasitet, por edhe në një zgjerim të zhvillimeve socio-ekonomike. Për më tepër, modernizimi dhe novacioni i AFP-së është një parakusht thelbësor i aftësimit dhe zhvillimit të aftësive të të rinjve dhe të rriturve, duke përcaktuar kështu të ardhmen e krijimit të punëve dhe të aftësisë për t'u përshtatur ndaj ndryshimeve.

Duke hapur rrugë të reja të promovimit të aftësive dhe të AFP-së në Shqipëri, Albanian Skills provoi se ishte partner i dashur i nxënësve, mësuesve, kompanive dhe institucioneve përkatëse të lidhura me AFP-në, duke sjellë dhe mbështetur zërat e tyre në komunitetin lokal dhe ndërkombëtar. Për qëllimin e lartpërmendur, ne gjithashtu jemi në ndryshim dhe përshtatje të vazhdueshme të procesit tonë të njohurive. Për më tepër, ne po punojmë dhe kontribuojmë në mënyrë konstante për zhvillimin, novacionin dhe sipërmarrjen sa u përket aftësive në Shqipëri dhe jashtë. Duke pasur parasysh këto, ne do të donim të theksonim angazhimin dhe dedikimin tonë ndaj mbështetjes dhe zhvillimit të aftësive, në mënyrë që rinia e vendit tonë të jetë e guximshme dhe e dalluar në rrugën e saj profesionale.

Me Revistën tonë INNOVET Albania, e cila sapo e ka nisur rrugëtimin e saj, ne rikonfirmojmë përpjekjet tona të forta për një të ardhme më të mirë dhe një rini më të aftësuar në një botë në zhvillim të jashtëzakonshëm dhe të ardhmen e saj! Lexim të mbarë, Krishtlindje të Gëzuara dhe fillim të mbarë në një 2021 me shëndet dhe begati për të gjithë ju dhe familjet tuaja!

Me dashuri
Ekipi i Albanian Skills

PËRSE KONKURSET KOMBËTARE TË AFTËSIVE NË SHQIPËRI?



Konkurset Kombëtare të Aftësive janë një zë i fortë për të ndihmuar në ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e aftësive dhe sistemin e AFP (Arsimi dhe Formimit Profesional) në mbarë botën, e veçanërisht për aftësitë e AFP-së në Shqipëri. Nisur 6 vite më parë, synimi ynë është që nëpërmjet konkurseve kombëtare t'i japim brezit të ri një mundësi për të shfaqur talentet e tyre dhe t'i ekspozojmë ata me një game të gjerë konkurseve për aftësitë si pjesë e jetës së tyre të përditshme, në mënyrë që ata të prezantohen me aftësitë dhe standartet profesionale që kërkon tregu përkatës i punës. Përgjatë viteve, konkurset e aftësive pasurohen me disiplina të reja, duke u ofruar të rinjve nga 16 në 25 vjeç, një mundësi për të konkurruar në fusha të ndryshme ku ata kanë interes. Me shumë se 150 të rinj morën pjesë në konkurset e këtij viti, si konkurrentë, juri dhe vullnetarë. Ne jemi të lumtur që ata na u bashkuan pavarësisht kësaj kohe të vështirë dhe kufizimeve të pandemisë. Konkurrentët në shtatë disiplina kryesore si: Software Development; Web Development; Sipërmarrje në Biznes; Fotografi; Graphic Design; Aftësi për Parukier & Berber; dhe Shërbime Hotelerie & Restorantesh, konkurruan gjatë një dite dhe u prezantuan me workshope të ndryshme dhe mundësi trajnimesh për t'i zhvilluar aftësitë e tyre më tej dhe për t'u futur në tregun e punës dhe biznesit. Ishte objektivi, e në të njëjtën kohë edhe aspirata e organizatës sonë, që brezi i ri i talentuar shqiptar të ketë mundësinë për të konkurruar në Konkurset e Aftësive Profesionale Evropiane. Këtë vit, ne jemi të lumtur të ndajmë me ju se Shqipëria do të përfaqësohet në Euroskills 2020 nga ekipi fitues i konkursit Sipërmarrja në Biznes dhe një vizite studimore për fituesit e konkurseve të tjera.

Edicioni i 6-të i Konkurseve Kombëtare të Aftësive Shqiptare për vitin 2020 u përmbyll me sukses!



Qëndroni me ne dhe zbuloni më shumë në Buletinin e radhës INNOVET ALBANIA Numër 2, Janar 2021!!

- Inovacioni në AFP në Shqipëri - Histori Suksesi
- Shpallja e Javës së Aftësive Shqiptare 2021
- Thirrja e Studentëve nga Intervet WB
- Dëshmi nga Praktikantët e Albanian Skills
- Kafeja e Pasdites 5


Në Dhjetor 2020, eventi i 4-t i Kafesë së Pasdites që u fokusua te "Biznesi dhe Arsimi Profesional", konfirmoi nevojën e më tepër initiative nga shkollat për forcimin dhe përmirësimin e dialogut me bizneset, në lidhje me përshtatjen e tregut relevant të punës me procesin e të mësuarit në shkollë. Pjesëmarrës nga bota e biznesit, drejtues të shkollave të AFP-së dhe stafi i tyre hapën shumë diskutime, duke rezultuar në një raund tjetër me të njëjtin fokus në janar 2021!

INTERVET WESTERN BALKANS NJË PERSPEKTIVË E SHKËLQYER PËR ARSIMIN PROFESIONAL

Raport nga Ekipi i Albanian Skills

**7 Destinacione
Mobiliteti:**

- Itali
- Spanjë
- Poloni
- Slloveni
- Francë
- Maltë
- Holandë



Thirrja e parë e studentëve është mbyllur së fundmi dhe janë përzgjedhur dhjetë studentë shqiptarë për një praktikë profesionale 1-mujore në Forli, Itali!

Objektivi i përgjithshëm i projektit INTERVET WB është të përmirësojë cilësinë e arsimit të AFP-së në Ballkanin Perëndimor, rrjedhimisht të mbështesë punësimin e të rinjve. Ky projekt konsiston në katër aktivitete kryesore të drejtuara ndaj stafit akademik dhe studentëve të AFP-së. Aktivitetet kryesore janë Job Shadowing, Shkolla Verore, Praktika Profesionale dhe Thematic Themes. Meqenëse Aftësitë AFP po kthehen hap pas hapi në “aftësitë e së ardhmes”, brezi i ri po i drejtohet gjithnjë e më shumë Arsimit të AFP-së.

Ndërkombëtarizimi i Sistemeve të AFP-së në Ballkanin Perëndimor është një mundësi e shkëlqyer për të rinjtë që të ndjekin një internship/praktikë profesionale/shkëmbim tremujor. Kjo eksperiencë u jep atyre mjetet e duhura për të qenë të guximshëm dhe të dalluar në fushat e tyre të studimit, duke kthyer në vendin e tyre njohuritë e përgjithshme dhe rezultatet e mësuara. Për më tepër, Projekti INTERVET WB do të vazhdojë të krijojë mundësi shkëmbimi deri në vitin 2023, duke pasur një impakt të madh në Sistemin Arsimit të AFP-së në Ballkan.

JAVA E AFTËSIVE SHQIPTARE 2020 KONTRIBUTI I SAJ NË JAVËN E AFTËSIVE EVROPIANE 2020

Raport nga Ekipi i Albanian Skills

Java e Aftësive Shqiptare është një javë plot me aktivitete për profesionistët e rinj në fusha të ndryshme të punës dhe të studimeve, organizuar që prej 2018 dhe e frymëzuar nga Java e Aftësive Evropiane. Ajo përmban disa nga temat më të rëndësishme për informimin e brezit të ri, me fokus në inovacion dhe digjitalizim përmes aktivizimit të teknologjive më inovative, industrive dhe zgjidhjeve për studentët e mësuesit të AFP në formën e workshop-eve, trajnimeve, forumeve dhe diskutimeve. Java e aftësive e këtij viti, e cila u organizua dhe u implementua online gjatë datave 25-30 maj 2020 si pasojë e pandemisë, rezultoi një sukses i vërtetë. Temat kryesore lidheshin me Inteligjencën Artificiale, Energjinë e Qëndrueshme nga Schneider Electric, Inteligjencën Emocionale, Aftësitë për një Jetë më të Sigurt, Botën e Punës, Klubin e Kodimit, Industrinë Kreative etj.; të gjitha të përmblytura me sukses dhe pjesëmarrje të lartë. Përgjatë Javës Evropiane të Aftësive e cila u zhvillua online më 9-13 nëntor në Berlin, Albanian Skills kontribuoi në dy evente të ndryshme: në panelin e folësve në Konferencën e Ndërkombëtarizimit të AFP-së dhe në Ceremoninë e Mbylljes së Ekselencës së AFP-së.

Për më tepër shikoni: <https://ec.europa.eu/social/vocational-skills-week/>



KËNDI I DËSHMIVE - PROGRAMI I PRAKTIKAVE @AS

DY FJALË NGA PRAKTIKANTET E ALBANIAN SKILLS



“Kur mbyll një derë, ti e di se çfarë po lë pas, por jo se çfarë të pret”. Pasi përfundova studimet e mia, nuk kisha asnjë ide se çfarë do të gjeja në derën e radhës në karrierën time. Do ta përshkruaja këtë mundësi praktike si një “trampoline”, që më përgatiti për “kërcimin” e radhës në jetën time. Në Albanian Skills zbulova aftësitë e mia, zbulova veten!

Nga Fatma Memalli

Praktika ku jam regjistruar aktualisht, pranë OJQ-së “Albanian Skills”, është një mundësi e vlefshme dhe e shkëlqyer për të zbuluar aftësitë e mia. Në rrugëtimin tim të deritanishëm kam punuar në fusha të ndryshme, duke marrë shumë eksperiencë nga një perspektivë e ndryshme, që nuk e kisha hasur më parë. Ajo më ndihmoi të krijoj një vizion më të qartë për të ardhmen time të afërt. Të jesh pjesë e Albanian Skills do të thotë të rrethohesh nga njerëz mirëkuptues dhe pozitivë!

Nga Luljeta Hoda

